



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC

635  
Nr. \_\_\_ prot.

Roskovec, më 7.06.2026

**SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE  
SHEF I POLICISË BASHKIAKE NË POLICINË E BASHKISË ROSKOVEC**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë; të Ligjit nr.89/2022, datë 22.12.2022 “Për Policinë Bashkiake”; VKM-së nr.452 datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”; Rregulloren e Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës së Bashkisë Roskovec si dhe Njësi Administrative në varësi Kuman, Strum, Kurjan” si dhe në Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Roskovec Nr. 1, datë 06.01.2026 “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum si dhe organigramës për vitin 2026”;

**Shef i Policisë Bashkiake në Policinë e Bashkisë Roskovec 1 (një) vend**

**Përshkrimi i përgjithshëm i punës:**

- a) organizon, drejton, kontrollon dhe përgjigjet për sigurimin e zbatimit të detyrimeve dhe kompetencave që ka Policia Bashkiake;
- b) koordinon veprimtarinë e punës me Policinë e Shtetit për zbatimin e detyrimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e rendit e të sigurisë publike në parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme për aktivitetet që zhvillohen në territorin e bashkisë;
- c) planifikon aktivitetin në mbështetje të detyrave të caktuara për të siguruar realizimin në kohë të objektivave të përcaktuar;
- ç) kryen analiza, raporte, përshkrime që lidhen me veprimtarinë e Policisë Bashkiake;
- d) i propozon kryetarit të bashkisë kalendarin e trajnimeve për të siguruar kualifikimin periodik profesional të punonjësve të Policisë Bashkiake;
- dh) këshillon kryetarin e bashkisë dhe jep mendime për zgjidhjen e çështjeve në fushën e përgjegjësisë së tij.

**Kandidatët për policë duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë ose të ketë diplomë të barasvlershme me të ose të ketë përfunduar studimet e arsimit të lartë jashtë vendit dhe të ketë njohur dhe njësuar diplomën sipas përcaktimeve për njësimin e diplomave, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë, në shkenca shoqërore, juridike, ekonomike ose institucionet arsimore të sigurisë;

- e) të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në administratën publike, Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, Gardën e Republikës, Policinë e Burgjeve, Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, në profesionet e lira ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to në sektorin privat;
- f) të mos jetë subjekt i ndalimeve sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- g) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- h) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;
- i) të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;
- j) të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.

## **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) kërkesën;
- b) jetëshkrimin;
- c) fotokopjen e kartës së identitetit;
- ç) fotokopjet e noterizuara të diplomës të arsimit të mesëm të lartë;
- d) 2 (dy) foto me përmasa 4 x 6 cm;
- dh) raportin mjekoligjor mbi gjendjen shëndetësore;
- e) certifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
- f) vërtetimin nga prokuroria për qenien ose jo në ndjekje penale;
- g) vërtetimin nga gjykata për çështje në proces gjykimi;
- h) dokumentet për vërtetimin e përvojës në punë apo librezën e punës;
- i) vlerësimin e fundit të punës, kur aplikantët vijnë nga administrata publike;
- j) vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- k) vërtetimin që të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës, për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo në sportelet e Sektorit të Zyrës me Një Ndalesë (One Stop Shop) në Bashkinë Roskovec brenda datës 12.02.2026.

## **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT**

Pas verifikimit të dokumentacionit, në respektim të afatit ligjor, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Roskovec do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec, në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet testimi. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit dhe kërkesat e posaçme do të

njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail) për shkaqet e moskualifikimit. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec. Afati i ankimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

## **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

- a- ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"
- b- ligjin nr.89/2022, datë 15.5.1997 "Për Policinë Bashkiake"
- c- VKM nr.452 datë 26.07.2023 "Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake"
- d- VKM nr. 494, datë 24.08.2023 "Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të policisë bashkiake"
- e- Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.
- f- ligjin nr.9131/08.06.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"

## **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

### **Testimi me shkrim**

Kandidatët në testimin me shkrim do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;

**Kandidatët që marrin 60% (24 pikë) të pikëve të testimit me shkrim, kanë të drejtë të vazhdojnë fazën e Testimit fizik**

### **Testimi fizik**

Testimit fizik u nënshtrohen të gjithë kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim për praninë në Policinë Bashkiake. Do të testohen aftësitë psikomotore të kandidatit, ku përfshihen shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca dhe koordinimi fizik.

**Kandidati që merr mbi 60% të pikëve (12 pikë) të përcaktuara për testimin e aftësive fizike vazhdon konkurrimin.**

### **Intervista**

Kandidatët, që rezultojnë fitues në fazat e tjera të testeve, i nënshtrohen intervistës.

Kandidatët në intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Në Intervistë, totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 20 (njëzet) pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) jetëshkrimi (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, deri në 10 pikë;  
b) intervista, deri në 10 pikë.

**Rezultati i përgjithshëm i kandidatit përcaktohet mbi shumatoren e rezultateve të arritura nga testimi me shkrim, testimi fizik dhe intervista.**

Totali i pikëve për vlerësimin e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

Vlerësimi maksimal për testimin me shkrim është	<b>60 pikë</b>
Vlerësimi maksimal për testimin e aftësive fizike është	<b>20 pikë</b>
Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është	<b>20 pikë</b>

**Kandidatët që marrin mbi 60 pikë janë kandidatët fitues.**

### **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimin të kandidatëve, për çdo fazë (testimit me shkrim, testimit fizik dhe intervistës me gojë) Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Roskovec do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec dhe në stendat e informimit të publikut.

Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim në Komisionin Përzgjedhës për rezultatin e pikëve dhe renditjen në listën fituese. Afati i ankimit fillon brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga:

- a) data e njoftimit të rezultatit të verifikimit paraprak të kandidatit;
- b) data e njoftimit të rezultatit të vlerësimin me shkrim;
- c) data e njoftimit të rezultatit të testimit të aftësive fizike;
- ç) data e njoftimit të rezultatit të vlerësimeve për kandidatët, të cilët kanë marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimin të përcaktuara.

Komisioni përzgjedhës njofton vendimin brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor.

Në përfundim të këtij afati, njësia e burimeve njerëzore publikon listën përfundimtare fituese.

**KRYETAR**  
**Majlinda Buqi**

